



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3697/7 prot.

Datë 28.01.2026

V E N D I M
Nr. 155/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.01.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “EGIAN MED” PF në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63574-10-03-2025, me objekt “Loti 1 - F.V. shtretër spitalorë për obstetri - gjinekologji për nevojat e SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”, me fond limit 8,848,666.66 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 17-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Albadent Group” ShPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a., Adresa: Rruga “Reshit Çollaku” Godina Nr.6/337, Tiranë.

- Ankimues:** Operatori ekonomik “EGIAN MED” SHPK me Nipt, L71715003C, Adresa: Nj.Ad. 7, “Rruga e Kavajës”, godina “Condor Centre”, kt. 4, Tiranë.
- OE “Biometric Albania” SHPK me NUIS J61827062E, me adresë: Blv: “Zhan D'ark”, Pallati 53, Ap. 6b, Tiranë.
- Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK, me Nipt. L62217032L Adresa: Rruga “Allaman Dervishi”, Pallati “Classic A.M.”, nr.31, kthesa e Kamzës, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë

qenë operatorë ekonomike në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatori ekonomik ankimues “EGIAN MED” SHPK dhe operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

1.5. Ankimuesit “EGIAN MED” SHPK dhe “Biometric Albania” SHPK kanë plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06-10-2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63574-10-03-2025, me objekt “Loti 1 - F.V. shtretër spitalorë për obstetri - gjinekologji për nevojat e SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”, me fond limit 8,848,666.66 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 17-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

II.2. Në datën 17-11-2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 11.12.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.“KONEX” SHPK	2,300,000	Skualifikuar
2.“QENDRA E MONITORIMIT TE MJEDISIT” SHPK	3,898,000	Skualifikuar
3.“ALBADENT GROUP” SHPK	5,555,007	Kualifikuar
4.“EGIAN MED” SHPK	5,700,000	Skualifikuar

(Nuk përmbush kërkesat e veçanta për kualifikim sipas pikës 2.3.1, Seksioni “Kapaciteti Teknik” pasi referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se ka paraqitur fatura shitje në vlerën 2,200,000 lekë, e cila nuk plotëson vlerën e kërkuar për shitje të ngjashme për pajisje mjeksore, në masën 40% e Fondit Limit ose 3,600,000 lekë pa TVSH).

5.“BIOMETRIC ALBANIA” SHPK	6,637,000	Kualifikuar
----------------------------	-----------	-------------

II.4 Në datën 19.12.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës në sistemin e prokurimeve elektronike dhe APP, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/6208, datë 24.12.2025 dhe me Nr. 3697/2025 Prot., datë 24.12.2025 e operatorit ekonomik “EGIAN MED” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63574- 10-03-2025, me objekt “Loti 1 - F.V. shtretër spitalorë për obstetri - gjinekologji për nevojat e SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”, me fond limit 8,848,666.66 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 17-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3697/1 prot, datë 29.12.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “EGIAN MED” SHPK si dhe me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ALBADENT GROUP” SHPK, në procedurën e mësipërme e prokurimit.

II.7. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit, ka përcjellë me shkresën nr. 3149/25 prot., datë 05.01.2026, protokolluar me tonën me nr.3697/2 prot., datë 06.01.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “Egian Med” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës me arsyetimin si më poshtë vijon:

“II.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “EGIAN MED” shpk për plotësimin e kërkesës për punën e ngjashme, KSHA arsyeton:

[...]

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimes “EGIAN MED” shpk, konkretisht faturat për pëmbushjen e kërkesës për punën e ngjashme, konstaton se ky i fundit përmbush kërkesat për paraqitjen e përvojës së mëparshme të ngjashme përcaktuar sipas kapacitetit ekonomik dhe financiar të kriterëve të veçanta të kualifikimit, modifikuar sipas Shtojcës Nr. 1. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se dokumentacioni i paraqitur në sistemin e

prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “EGIAN MED” shpk përmbush kërkesën e përcaktuar sipas kapacitetit ekonomik dhe financiar për përvojë të mëparshme të ngjashme në të treja aspektet e saj, konkretisht ngjashmërinë me objektin e procedurës së prokurimit, vlerën e përlllogaritur si dhe afatin kohor për kryerjen e këtyre shërbimeve gjatë tre viteve të fundit. Vlera e përlllogaritur e kontratave e tejkalon vlerën e kërkuar sipas kriterit për punë të ngjashme, të modifikuar, në masën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

VENDOSI

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “EGIAN MED” shpk.

2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi”.

II.8. Me anë të shkresës nr.3149/26 prot., datë 05.01.2026, protokolluar me tonën me nr.3697/3 prot., datë 06.01.2026 autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, ka dërguar vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK me po të njëjtën përmbajtje ku ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës si referuar shkresën e sipërcituar së bashku me dokumentacionin fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK.

II. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente në cilësinë e subjektit të intersuar nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.9. Në datën 29.12.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3721/2025 protokoli, me datë 29.12.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/6222 e OE “Biometric Albania” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63574-10-03-2025, me objekt “Loti 1 - F.V. shtretër spitalorë për obstetri - gjinekologji për nevojat e SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”, me fond limit 8,848,666.66 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 17-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

II.10. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprahe” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3721/1 prot, datë 29.12.2025, lidhur me

kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente shtesë nga operatori ekonomik ankimues në datë 29.12.2025 protokolluar me tonën nr. 3721/2, datë 30.12.2025. E njëjta shkresë është dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues dhe nëpërmjet shërbimit postar protokolluar me tonën me nr.3721/3 datë 31.12.2025.

II.12. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente në cilësinë e subjektit të interesuar nga operatori ekonomik “Albadent Group” shpk në datë 05.01.2026 protokolluar me tonën nr. 3721/4, datë 06.01.2026, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, për procedurën e prokurimit.

II.13. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit, ka përcjellë me shkresën nr. 3149/28 prot., datë 07.01.2026, protokolluar me tonën me nr.3721/5 prot., datë 07.01.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Biometric Albania” shpk. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur mos pranimin e ankesës se sipercituar.

II.14. Me anë të shkresës nr.3149/29 prot., datë 06.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3721/6 prot., datë 08.01.2026 autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, ka dërguar vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Biometric Albania” shpk me po të njëjtën përmbajtje ku ka vendosur mos pranimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën nr. A/2025/6208, datë 24.12.2025 dhe me Nr. 3697/2025 Prot., datë 24.12.2025 të operatorit ekonomik “Egian Med” shpk, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit

të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit, ka përcjellë me shkresën nr. 3149/25 prot., datë 05.01.2026, protokolluar me tonën me nr.3697/2 prot., datë 06.01.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Egian Med” shpk. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës me arsyetimin si më poshtë vijon:

“II.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “EGIAN MED” shpk për plotësimin e kërkesës për punën e ngjashme, KSHA arsyeton:

[...]

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues "EGIAN MED" shpk, konkretisht faturat për pëmbushjen e kërkesës për punën e ngjashme, konstaton se ky i fundit përbush kërkesat për paraqitjen e përvojës së mëparshme të ngjashme përcaktuar sipas kapacitetit ekonomik dhe financiar të kriterëve të veçanta të kualifikimit, modifikuar sipas Shtojcës Nr. 1.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se dokumentacioni i paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik "EGIAN MED" shpk përbush kërkesën e përcaktuar sipas kapacitetit ekonomik dhe financiar për përvojë të mëparshme të ngjashme në të treja aspektet e saj, konkretisht ngjashmërinë me objektin e procedurës së prokurimit, vlerën e përllogaritur si dhe afatin kohor për kryerjen e këtyre shërbimeve gjatë tre viteve të fundit. Vlera e përllogaritur e kontratave e tejkalon vlerën e kërkuar sipas kriterit për punë të ngjashme, të modifikuar, në masën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

VENDOSI

- 1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “EGIAN MED” shpk.*

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115, pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se : *“1.Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë: a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin: i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar; ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji; b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji; c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës. “2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”*

Për këtë arsye, **KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me pretendimet e pranuar nga autoriteti kontraktor të ankesës** me numër ankimi elektronik nr. A/2025/6208, datë 24.12.2025 dhe me Nr. 3697/2025 Prot., datë 24.12.2025 e operatorit ekonomik “EGIAN MED” shpk për procedurën e prokurimit.

III.2. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” shpk me mbi kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albadent Group” shpk me arsyen se *“Ky OE nuk ka plotësuar saktë pikën a. Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9; Konkretisht nuk ka deklaruar për Administratoren dhe Ortaken për pikën: Personi/personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____etj. Nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjecare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Nuk ka dhënë të gjithë informacionin për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e të cilit do të kryhet verifikimi në lidhje me pikat: - inuk ka paguar detyrimet e energjisë elektrike për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit sipas pikës më poshtë. Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet*

e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e republikës së shqipërisë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshmeë - Nuk ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore sipas pikës më poshtë.Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____ Nuk ka deklaruar saktë inxhinier biomjekësor ose elektronik ose informatik ose elektrik, të trajnuar për pajisjen objekt prokurimi për të cilën oferton”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në pikën 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, të shtojcës 9, “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor ka kërkuar;

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

2. Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

3. A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

- Gjithashtu në DST është kërkuar në shprehjen 8 të tyre “**2. Kriteret e veçanta të kualifikimit konkretisht :**

“**2.3.11.** Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij inxhinier biomjekësor ose elektronik ose informatik ose elektrik, të trajnuar për pajisjen objekt prokurimi për të cilën oferton.

Per kete duhet te paraqesë:

- Diplomen perkatese
- CV
- Kontrate individuale pune
- Certifikata / ose deshmi trajnimi të tyre për pajisjen objekt prokurimi për të cilën oferton.

**Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.”*

III.2.2. Operatori ekonomik “Albadent Group” shpk, ka dorëzuar si në dokumentacionin fizik, me shkresën nr. 3149/26 prot, datë 05.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3697/3 prot, datë 06.01.2026,

të dorëzuar nga autoritetit kontraktor Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën II: Shkaqet e përjashtimit a: Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit si dhe për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “Deklaratë” Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar:

- Formular_vetedeklarimi_Albadent_Group, si më poshtë:

Deklarata Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Dokumentacioni është i disponueshëm në formë elektronike. Adresa e web-it: https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/ https://e-albania.al/ Autoriteti ose organi lëshues: Qendra Kombëtare e Biznesit Lloji i dokumentacionit: Ekstrakt Tregtar + Ekstrakt Historik Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Dokumentacioni është i disponueshëm në formë elektronike.

Adresa e web-it: https://e-albania.al/ Autoriteti ose organi lëshues: Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) Lloji i dokumentacionit: Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti) Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: 1. etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Dokumentacioni është i disponueshëm në formë elektronike. Adresa e web-it: https://e-albania.al/ Autoriteti ose organi lëshues: Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) Lloji i dokumentacionit: Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti)
--

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:

Vërtetim Debie nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU).

www.e-albania.al

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:

Dokumentacioni është i disponueshëm në formë elektronike:

Adresa e web-it: <https://e-albania.al/>

Autoriteti ose organi lëshues: Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Njësitë e Qeverisjes Vendore

Lloji i dokumentacionit: Vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin, Vërtetim për pagim detyrimesh, Për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore.

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>
Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Po ☒ Jo ☐ Nëse, po, numri i punonjësve: 1 - Profili i punonjësve Inxhinier <u>Makineri e mjete</u> Po ☐ Jo ☐ Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

Për disponimin e punonjësit të kërkuar në kriterin 2.3.11 të dokumentave të tenderit është dorëzuar gjithashtu Certifikata e trajnimit , datë 04.11.2025, nga prodhuesit prej te cilit është marrë dhe

autorizimi i kerkuar konkretisht “Jiangsy Youngxin Medical Equipment Co.,Ltd” ku deklarohet se Mrs.M.B, inxh. Biomedical ka përfunduar me sukses trajnimet për pajisjet e kërkuara.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”* Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: 40 a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”* Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.2.5. Në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në*

ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”. **2.** Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. **3.** Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. **4.** Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. **5.** Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “**3.** Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.2.6. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 4, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

parashikohet se: “**4.** Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”

III.2.7. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht : “**1.** Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.”.

III.2.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “**1.** Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. **2.** Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: **a)** operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv; **b)** operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; **c)** personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; **ç)** operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; **d)** operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; **dh)** operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe

tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPPsë; **e)** operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; **ë)** operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; **f)** operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; **g)** operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; **gj)** operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; **h)** operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); **44 i)** operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; **j)** informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; **k)** operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi. **3.** Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. **4.** Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. **5.** Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. **6.** Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h” “i”, “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. **7.** Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.2.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në këtë procedurë prokurimi, Komisioni konstaton se në fazën e ofertimit operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar shtojcën 9 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” ku në pjesën II: Shkaqet e përjashtimit a: Deklarata për

përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit si dhe për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ Deklaratë” Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar informacionin e kërkuar. Akoma më tej, Komisioni referuar shkresës nr. 3149/26 prot, datë 05.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3697/3 prot, datë 06.01.2026, konstaton se operatori ekonomik “Albadent Group” shpk për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.11 “Kapaciteti teknike”. Të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, të shtojcës 8 “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka dorëzuar dokumentacionin fizik që vërteton se punonjësi i stafit të tij dhe përkatësisht si në pikën **III.2.2** të këtij vendimi, në përputhje me deklarimeve të bëra në Seksionin B “DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” të shtojcës 9 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë e dokumentacionit të ofertës të dorëzuar në fazën e ofertimit nga ana e këtij operatori ekonomik ankimues. Lidhur me arsyet e tjera të pretenduara për mos plotësimin e shtojcës 9 pasi nuk ka dhënë të gjithë informacionin për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e të cilit do të kryhet verifikimi në lidhje me pikat: për detyrimet e energjisë elektrike dhe detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, KPP gjykon se dokumentacioni i ngarkuar në SPE dhe i dorëzuar fizikisht tek autoriteti kontraktot në funksion të shtojcës 9 sipas deklarimeve të bëra në këtë shtojcë të përcaktuar në pikën **III.2.2**. Të këtij vendimi, autoriteti kontraktor me të drejtë ë ka konsideruar të përmbushur kriterin dhe shtojcën dhe pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” shpk nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” shpk me mbi kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albadent Group” shpk me arsyen se “Ky OE Nuk plotëson pikën 2.3.7. Të kriterëve të veçanta të kualifikimit operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë/skeda teknike për artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara. Në katalogët / skedat teknike të paraqitura, duhet të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), specifikimet teknike sipas DST. (katalogët / skedat teknike duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT)ë. Duke pas eksperiencë në fushën e pajisjeve mjekësore ne i njohim shumë mirë konkurentët tonë dhe konkretisht kompaninë Albadent Group e cila ka eksperiencë në fushën e materialeve dentare. Katalogu i paraqitur nga kompania Albadent Group shpk nuk plotëson specifikimet teknike si më poshtë. Për produktin nr 1. Shtrat ekzaminimi gjinekologjik nuk plotëson: 1. Sistemi higjienik dhe grumbullimi i mbetjeve: Specifikimet kërkojnë kushte të qëndrueshme higjienike me sistem të integruar grumbullimi të mbetjeve, i pastrueshëm dhe i dezinfektueshëm në mënyrë të integruar në tavolinë - Produkti i ofruar nuk garanton sistem të integruar dhe funksional sipas përshkrimit teknik të kërkuar. 2. Materiali dhe ndërtimi i strukturës së shtratit Sipas specifikimeve kërkohet strukturë prej celiku i lyer elektrostatik, me veshje plastike antibakteriale dhe qëndrueshmëri të lartë strukturore - Nuk plotësohet specifikimi i materialit të shtratit dhe strukture prej Aeliku. 3. Pozicionimi dhe

funksi­onet ergonomike Specifikimet kërkojnë: Rregullim elektrik te lartesisë Pozicion Trendelenburg 20 gradë Pjesa e pasme e rregullushme deri ne 50 gradë Kontrolli i duarve dhe këmbëve për ngritje, rënie dhe pozicionimi i shpinës - Produkti i ofruar nuk përmbush ose nuk dokumenton saktë këto funksione, duke mos garantuar përdorim ergonomik dhe siguri për mjekun dhe pacientin. 4. Dimensionet teknike Specifikimet teknike: gjerësia/gjatësia:630 x 1700mm lartësia minimale: 720mm lartësia maksimale 970mm - Produkti i ofruar nuk plotëson dimensionet teknike dhe specifikimet. 5. Aksesorët dhe pajisjet ndihmëse Specifikimet kërkojnë: mbështetëse këmbësh të bazës aksesorë për procedura të ndryshme gjinekologjike mbështetëse standard për këmbë Rrota të lëvizshme të fshehura -Produkti i ofruar nuk përmbush tërësisht konfigurimin e kërkuar te aksessoreve standard. Për produktin nr. 2 Shtrat lindje nuk plotëson specifikimet e mëposhtme: Mbështetje standarde për këmbët me rripa (Áift) Rezervimi i baterisë Seksioni i rrëshqitjes i këmbës duke përfshirë tapicerinë. Dyshek pa tela me lëkurë statike bakteriale. Funksionet Trendelenburg, elektrike dhe CPR manuale. Mbajtëse për infuzion në të dy anët e shtratit Mbrojtëse anësore me kontroll Paneli fiks me komanda Rrotat lëvizëse 150 mm, njëra e drejtuar, Sistemi i përbashkët i potencialit elektrik, zgjedhja nga opsionet standarde të ngjyrave. Po ashtu, oferta nuk përmbush parametrat teknikë të dimensioneve dhe specifikimeve të kërkuara: Gjatësia totale e zonës së shtrirjes: 2122 mm. Gjatësia minimale në cilësimin: 1600 mm - 2200 mm, Gjerësia: 980 mm - 1200 mm, Ngarkesa maksimale e pacientit 240 kg Mbrojtje nga depërtimi i shtratit të lindjes IPX4 Klasa e pajisjes I. Klasifikimi i pjesëve të aplikuara B Pesha e përgjithshme e produktit Min 245 kg. Këto mospërputhje janë të rëndësishme dhe ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë, funksionalitetin dhe sigurinë e produktit që do të blihet, duke cënuar standardet minimale të përcaktuara në dosjen e tenderit.” , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në pikën 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, të shtojcës 8, “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë / skeda teknike për artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara. Në katalogët / skedat teknike të paraqitura, duhet të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), specifikimet teknike sipas DST. (Katalogët / skedat teknike duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT).

- Ndërsa në shtojcën 6 “formulari i specifikimeve teknike” autoriteti kontraktor ka kërkuar:

LOT 1 – FV HOSPITAL BEDS FOR OBSTETRICS – GYNECOLOGY FOR THE NEEDS OF SUOGJ “QUEEN GERALDINE”

No	Description The the article	specification TECHNICAL THE SPECIAL
1	BED examination gynecological 	BED examination gynecological ëith pilloë polyurethane : Conditions THE LASTING hygienic ëith collection system THE Ëastes THAT purified easily AND integrated disinfectant IN table THANKS feature OF THE PROdUCER concave THE round Pilloë THAT PROVIDES conditions SANITARY AND PROVIDES COMFORT the patient ëith his ability ABOUT BE clean IN compliance ëith decontamination hospital dealer The coverage OF THE roll The positioned IN the back side ABOUT THE MEET comfort needs AND hygiene OF THE PATIENT Parts integrated padded table extension IN the seat frame , ëhich ëins mobility ëith the system telescopic THE railroad ëhen needed Accessories SUPPORT THE ankles AND GROUND easily THE interchangeable THAT uSED ABOUT procedure THE MISCELLANEOUS gynecological BODY FROM steel The painted electrostatic LOT The sustainable AND clothing plastic antibacterial Standard supporter ankles AND accessories SUPPORT ABOUT HEEL examination ergonomic AND diagnostic mEDICAL convenience ABOUT doctor control The HANDS AND The leg ABOUT THE CONDUCTED movements of rising , falling , position trendelenburg AND section THE backpack Hidden ëheel Ëidthx Height 630×1700 mm Height (min.) 720 mm (ëith cushion)

		Height (maximum) 970 mm (ëith cushion) Position angles : Rear 50 ° regulation The height 720-970 mm Trendelenburg 20°
--	--	---

2	BED EAST 	stature EAST — Support standard ABOUT strapped legs feet (pair) — Reservation The battery — Section slide The foot including seating — Leather cordless mattress static bacterial — Trendelenburg, ELECTRICITY and manual CPR — Holder ABOUT infusion IN THE two sides of the bed — Protectors side with controls — Panel fixed with commands — Gloves (pair) — Castor wheel 150 mm, 1× i directed Central brake — System THE Single POTENTIAL electrical — Choice BY options standard THE COLOR — Packaging settings TECHNICAL Length total area OF THE extension 2122 mm Length minimum IN setting 1600mm- 2200mm Width 980 mm- 1200mm loads maximum patient weight 240 kg settings ELECTRICITY Batteries – backup 24V/1.2 Voltage – input 230 V tension The 24 V motor DEFENSE BY PENETRATION The bedside THE IPX4 waterproof Device class I. Distribution The parts THE applied B Total product weight Minimum 245 kg.
---	--	--

III.3.2. Operatori ekonomik “Albadent Group” shpk, ka dorëzuar si ne dokumentacionin fizik, me shkresën nr. 3149/26 prot, datë 05.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3697/3 prot, datë 06.01.2026, të dorëzuar nga autoritetit kontraktor ashtu dhe në SPE katalogun e markuar ne gjuhën angleze me të dhëna te identifikueshme dhe të markuara për verifikim e tyre në plotësim të kriterit dhe specifikimeve të mësipërme.

III.3.3. Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij

neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.3.4. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet “Specifikime teknike” janë: “b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

III.3.5. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” shpk duke pretenduar kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur prej operatori ekonomik “Albadent Group” shpk, Komisioni i prokurimit publik referuar verifikimeve të dokumentacionit të dorëzuara nga operatori ekonomik “Albadent Group” shpk rezulton se pretendimi i sipërmendur nga OE ankimues “Egian Med” shpk nuk qëndron dhe specifikimet janë qartësisht të përmbushura dhe të markuara për identifikimin e tyre. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

Për sa më sipër arsyetuar pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” shpk nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik “Egian Med” shpk përsa i perket kualifikimit të operatorit ekonomik “Albadent Group” SHPK, me arsyen se “Ky OE nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikatën ISO 13485:2016 për pajisjet mjekësore - Sistemet e menaxhimit të cilësisë (e vlefshme) ose ekuivalente ne perputhje me objektin e prokurimit. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata ISO e këtij OE nuk është për pajisje mjekësore në objekt prokurimi por për pajisje dentare dhe si e tillë është e pavlefshme duke mos e plotësuar këtë kriter kualifikimi.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në pikën 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, të shtojcës 8, “Formular i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

2.3.3 *“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikatën ISO 13485:2016 për “Pajisjet mjekësore - Sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalente ne perputhje me objektin e prokurimit. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.”*

III.4.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, OE “Albadent Group” shpk ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) ashtu si dhe dokumentacionin fizik, me shkresën nr. 3149/26 prot, datë 05.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3697/3 prot, datë 06.01.2026, të dorëzuar nga autoritetit kontraktor, dokumentacionin si më poshtë:

-Certifikatën **ISO 13485:2016 për “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”** e aplikueshme për pajisjet mjekësore konkretisht Prodhimi dhe shitja e krevateve manuale spitalore, krevateve për foshnje, krevateve për fëmijë, barelave, karrocës së transferimit të pacientëve, karriges së dializës, tavolinës kirurgjikale, krevatit ortopedik me tërheqje, divaneve të ekzaminimit, barelës me shkallë, karrocës mjekësore, ngritëses së pacientëve (brenda fushëveprimit të kualifikimeve të licencuara); prodhimi dhe shitja e krevateve elektrike spitalore dhe pajisjeve të tërheqjes të leshuar në datë 22.02.2024 dhe me vlefshëri deri në datën 22.02.2027.

II.4.3. Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike,

financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre

me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor. 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. 4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

III.4.4. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.4.5. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji. KPP konstaton se, duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me kualifikimin e OE “Albadent Group” shpk se: *Certifikata ISO e këtij OE nuk është për pajisje mjekësore - objekt prokurimi por për pajisje dentare dhe si e tillë është e pavlefshme duke mos e plotësuar këtë kriter kualifikimi.”*, nga verifikimi i dokumentave të tenderit si dhe dokumentave të ngarkuara në SPE ashtu dhe të dorëzuara fizikisht

nga me shkresën nr. 3149/26 prot, datë 05.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3697/3 prot, datë 06.01.2026, nga autoritetit kontraktor, OE ekonomik “Albadent Group” shpk ka dorëzuar dokumentacionin e listuar në pikën **III.4.2** të këtij vendimi. Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3. të shtojcës 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, ka përcaktuar: kërkesën për certifikatën e **Sistemet e menaxhimit të cilësisë EN-ISO 3834-2:2021 ISO 13485:2016 për “Pajisjet mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit dhe qartazi** konfirmohet se certifikatat ISO e dorëzuara nga operatori ekonomik “Albadent Group” shpk për sa kohë nga vetë përmbajtja e dokumentit të ISO në të cilën citohet se është zbatueshme ose aplikueshme për: *Prodhimi dhe shitja e krevateve manuale spitalore, krevateve për foshnje, krevateve për fëmijë, barelave, karrocës së transferimit të pacientëve, karriges së dializës, tavolinës kirurgjike, krevatit ortopedik me tërheqje, divaneve të ekzaminimit, barelës me shkallë, karrocës mjekësore, ngritëses së pacientëve (brenda fushëveprimit të kualifikimeve të licencuara); prodhimi dhe shitja e krevateve elektrike spitalore dhe pajisjeve të tërheqjes*, dhe vetë objekti i kësaj procedure është *“Loti I – F.V. shtretër spitalorë për obstetri – gjinekologji...”* pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” shpk nuk qëndron. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në kushtet e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit objekt - ankimi.

Për sa më sipër, pretendimi i OE “Egian Med” shpk ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me ankesën nr. A/2025/6222, me datë 29.12.2025 të operatorit ekonomik “Biometric Albania” shpk, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “Albadent Group” shpk, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme për operatorin ekonomik “EGIAN MED” shpk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “EGIAN MED” shpk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të vetë KSHA-së dhe K.P.P. do të mbetet i kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Albadent Group” shpk, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga suktesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qenë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar. Në këto kushte, KPP gjykon që ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6222 datë 29.12.2025 dhe me nr. 3721/2025 protokolli, me datë 29.12.2025 e ankimuesit “Biometric Albania” shpk nuk do të merren në shqyrtim.

III.5.1. Parashikimi i nenit 110 e vijues të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin.

III.5.2. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejt nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.5.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës, për sa kohë që përpara tij me vlerë më të ulët vijon të qëndrojë i kualifikuar një operator ekonomik edhe pas ankesës së bërë prej tij. Pra, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka se si të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi. Pasi për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve mbi s’kualifikimin e operatorit ekonomik “Egian Med” shpk, të palës ankimuese, vetë KSHA gjykoi se këto të fundit qëndrojnë dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik “Egian Med”, shpk do të vijojë të mbetet i kualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimuese për s’kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Albaadent Group” shpk, nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tij, për këtë operator ekonomik pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Egian Med” shpk, për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63574-10-03-2025, me objekt “*Loti 1 - F.V. shtretër spitalorë për obstetri - gjinekologji për nevojat e SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”*”, me fond limit 8,848,666.66 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 17-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Të mos pranojë pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik “Egian Med” shpk, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Biometric Albania” shpk, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
4. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke kualifikuar operatorin ekonomik “Egian Med” shpk në përputhje me konstatimet e KSHA-së dhe të këtij vendimi.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kalimin në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” shpk, dhe të operatorit ekonomik “Egian Med” shpk.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

